

PLATFORMË POLITIKASH NGA TË RINJTË E KOMUNËS SË PRIZRENIT

KORRIK - SHTATOR 2017



COPYRIGHT © 2017.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 34,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PROPOZIM-PLATFORMË POLITIKASH PËR KANDIDATË PËR KRYETAR KOMUNE NË PRIZREN ME QËLLIM TË ADRESIMIT TË ÇËSHTJEVE TË IDENTIFIKUARA SI PRIORITETE NGA GRUPI JOFORMAL I TË RINJVE

KORRIK - SHTATOR 2017





PËRMBLEDHJE

Konsolidimi dhe avancimi i qeverisjes së mirë, përveç tjerash kërkon pjesëmarrje aktive të qytetarëve në procesin e bërjes së politikave publike si dhe kërkim llogaridhënies nga politikanët. Pavarësisht mundësive dhe hapësirës që ofron korniza ligjore për pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e bërjes së politikave, sidomos atyre në nivelin komunal, përvoja e deritashme ka dëshmuar që pjesëmarrja mbetet shumë e vogël dhe e kufizuar kryesisht në dy takimet e obligueshme që organizohen brenda vitit me qytetarë. Kjo pjesëmarrje reduktohet edhe më shumë kur bëhet fjalë për të rinjtë, të cilët marrin pjesë në nivele pothuajse të papërfillshme të procesit të bërjes së politikave publike, e në veçanti të politikave që kanë implikime direkte në jetët e tyre.

Marrë parasysh këtë pjesëmarrje kaq të ulët të të rinjve në proceset vendimmarrëse, dhe me qëllim të nxitjes së të rinjve për pjesëmarrje aktive në proces dhe ngritjes së nivelit të përgjegjësisë nga ana e politikanëve, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) është duke zbatuar projektin **“Fuqizimi i votueseve të rinjve për të marrë vendime duke qenë të informuar, dhe duke i ndihmuar**

ata që t’i mbajnë politikanët llogaridhënës.” Fillimisht, në kuadër të këtij projekti është zhvilluar një hulumtim i opinionit publik me të rinj të moshave 17 deri 21 vjeç. Të gjeturat kryesore të këtij hulumtimi tregojnë një shpërputhje mes temave të servuara në baza të politikës ditore, dhe temave që realisht preokupojnë të rinjtë. Shqetësimet kryesore të të rinjve konsistojnë në mungesën e perspektivës së punësimit, zhvillimit ekonomik, nivelin e lartë të korrupsionit, gjendjen në sektorin e shëndetësisë dhe liberalizimin e vizave. Kurse, sa i përket institucioneve më të besueshme për të rinjtë, komuna cilësohet si institucioni më i besueshëm dhe vendi i parë ku të rinjtë tentojnë të adresojnë problemet e tyre.

Mungesa e komunikimit me politikanë apo zyrtarë të partive politike është element tjetër që reflektohet në të gjeturat e hulumtimit të opinionit publik. Më konkretisht, rezultatet tregojnë se 80% e të rinjve nuk kanë komunikuar dhe nuk kanë marrë pjesë **asnjëherë** në debate me politikanë apo zyrtarë të partive politike.





Më tutje, në funksion të përmirësimit të nivelit të pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe rritjen e nivelit të përgjegjësisë së politikanëve, KDI ka mbajtur fillimisht shtatë (7) punëtori dy-ditore dhe katër (4) debate publike mes të rinjve dhe të zgjedhurve të tyre. Gjatë punëtorisë për llogaridhënie, rreth 200 pjesëmarrës të rinj u trajnuan lidhur me format moderne të kërkim llogaridhënies, vënien në funksion të vlerave në politikë, sistemet zgjedhore dhe të tjera.

Gjatë debateve publike, është vërejtur se shumica e shqetësimeve të të rinjve janë adresuar për nivelin lokal të qeverisjes. Për këtë arsye, por edhe me qëllim të shtrirjes së kërkim llogaridhënies edhe në nivelin lokal, KDI ka vazhduar me organizimin e punëtorive për politikën e të rinjve, që si synim parësor kanë identifikimin, priorizimin dhe ofrimin e alternativave për problemet e të rinjve. Gjatë muajve qershor dhe korrik, janë mbajtur gjithsej shtatë (7) punëtori, në komunat më të mëdha të vendit: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj dhe Gjakovë.


Grupet e të rinjve të përbërë nga studentë, ndërmar-rës të rinj, përfaqësues të grupimeve rinore të partive politike në nivel lokal, gjatë punëtorive në fjalë kanë identifikuar disa çështje apo probleme që janë të nda-rra në pesë fusha (sektorë) që bien në kompetencë të komunës. Po ashtu, janë ofruar edhe propozime për masat dhe mënyrat si do të mund të adresoheshin nga ana e autoriteteve komunale. Këto probleme dhe ofrimi i masave për zgjidhjen e tyre janë përfshirë në këtë dokument që do të ndahet edhe në formë të platformave politike për kandidatët e mundshëm për kryetar komune në zgjedhjet lokale që do të mbahen në tetor 2017, në secilën nga komunat ku janë mbajtur punëtoritë.



PROCESI I BËRJES SË POLITIKAVE NË NIVELIN LOKAL

Bazuar në ligjet e aplikueshme (Ligji për Vetëqeverisje lokale), procesi i bërjes së politikave në nivelin komunal është përgjegjësi e Kryetarit të Komunës (ekzekutivi) dhe Asamblesë Komunale (legjislativi). Në praktikë, pjesa më e madhe e këtij procesi inicohet dhe derivohet nga ekzekutivi, derisa Asambleja rëndom përfshihet në proces të miratimit të politikave (vendime, rregullore) që sillen nga ekzekutivi. Përkundër faktit që me ligjet e aplikueshme komunat janë të pajisura me gamë të gjerë të kompetencave, është evidente që në shumë raste ka mungesë të buxhetit të mjaftueshëm për zbatim të projekteve të planifikuara dhe ofrim të shërbimeve të mira për qytetarët. Për pasojë, autoritetet komunale janë 'të detyruara' shumë herë të prioritojnë dhe zgjedhin çështjet dhe projektet që duhen zbatuar më parë.

Duke pasur parasysh kufizimet buxhetore si dhe problemet që ballafaqojnë komunat në procesin e hartimit të buxheteve komunale, diskutimi dhe puna e grupeve të rinjve është orientuar në identifikimin e çështjeve që janë të prekshme, të zbatueshme dhe që në pjesën më të madhe nuk kanë implikime të mëdha buxhetore. Çështjet e prioritetuara dhe të propozuara në këtë dokument nuk paraqesin një listë me dëshira.





OBJEKTIVAT

JANË DY OBJEKTIVA QË SYNOHEN
TË ARRIHEN:

1

Përfshirja e drejtpërdrejtë e të rinjve në procesin e bërjes së politikave publike duke ofruar propozime konkrete për çështjet që kërkojnë zgjidhje. Përfshirja ose jo e këtyre propozimeve nga ana e kandidatëve për kryetar komune në programet e tyre do t'iu shërbej të rinjve si mjet vlerësimi në marrjen e vendimeve të drejta.

2

Intensifikimi i komunikimit ndërmjet kandidatëve të mundshëm për zgjedhje komunale dhe qytetarëve, respektivisht të rinjve në identifikimin e problemeve dhe që diskutimet e përbashkëta me pjesëmarrje aktive qytetare të rrisin cilësinë e jetës së qytetarëve, respektivisht të rinjve.

Prioritetet e identifikuarra janë:

1

SEKTORI I RINISË



Problemet e identifikuarra:

Ligji për Fuqizimin e Rinisë dhe Strategjia për të rinjtë 2013-2017 përcaktojnë qartë rolin dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale në krijimin e hapësirës për përfshirje të të rinjve në procesin e bërjes së politikave rinore. Të gjitha objektivat strategjike që synon Strategjia për të rinjtë kanë të vetmin qëllim përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje dhe funksionalizimin e avancuar të sektorit të rinisë në nivelin lokal (Neni 3.1 i strategjisë).

Grupi i të rinjve i ka kushtuar vëmendje të posaçme gjendjes aktuale së të rinjve në komunë duke konstatuar që në përgjithësi ka mungesë të aktivizimit

vullnetar në komunën tonë. Rrjedhimisht ka identifikuar problemet në vijim që kërkojnë të trajtohen me prioritet nga ana e autoriteteve lokale:

- Mungesa e aktivizimit të të rinjve në aktivitete shoqërore po ndikon në rritjen e përditshme të një apatie qytetare.
- Aktivitetet që përfshijnë të rinjtë janë të pakta dhe shumë të kufizuara.
- Mungesa e mbështetjes konkrete për ide inovative mbi të cilat të rinjtë mund të nisin biznese të vogla.
- Ndarja e bursave nga komuna e kufizuar jo vetëm në numër, por edhe në fushat e studimeve që stimulohen.



Masat e propozuara – politika të nevojshme për të adresuar këto probleme:


1 Autoritetet lokale duhet të nxisin të rinjtë për përfshirje në aktivitete vullnetare duke ofruar mundësi për biletë autobusi falas ose me çmim të zbritur, bileta për kinema, teatër, bibliotekë komunale, pjesëmarrje në ngjarjet e organizuara nga autoritetet lokale etj.

2 Autoritetet komunale duhet të funksionalizojnë qendrën rinore dhe të njëjtë ta pajisin me kompetencë si koordinuese e punës vullnetare në komunë.

3 Përmes qendrës rinore, departamenti/sektori i rinisë në komunë të krijojë një bazë me të dhënat dhe kontaktet e të rinjve që regjistrohen si vullnetarë. Varësisht nga aktivitetet e organizuara nga drejtoritë gjegjëse, të rinjtë mund të informohen për aktivitete. Të rinjtë e regjistruar do të pajisen me kartela identifikuese. Në çdo fillim të vitit shkollor, stafi i qendrës rinore bënë një fushatë, së bashku me grupe vullnetarësh, për t'i informuar të rinjtë për mundësitë e përfshirjes në aktivitete vullnetare ashtu që ata që largohen të zëvendësohen me të rinj tjerë.

4 Autoritetet komunale të shikojnë mundësitë për nxitje të ndërmarrësve të rinj përmes mbështetjes financiare për nisjen e veprimtarive afariste. Këtu mendohet për idetë kreative dhe inovative që mund të nisin si projekte të vogla biznesi dhe që më pas mund të zgjerohen.

5 Autoritetet lokale të rishikojnë kriteret për ndarjen e bursave me qëllim të përfshirjes së studentëve nga më shumë drejtime dhe jo të jenë drejtimet e kufizuara. Po ashtu, të shikojnë mundësinë për shtimin e fondit për bursa për të mbështetur më shumë studentë në nevojë dhe meritore.





2

SEKTORI I INFORMIMIT



Problemet e identifikuara:

Komunikimi i mirë dhe në kohë me qytetarët nënkupton edhe siguri për autoritetet komunale. Qytetarët e informuar drejtë kanë mundësi të ofrojnë kontributin e tyre në projekte dhe ide të ndryshme që do të ishin edhe në shërbim të autoriteteve komunale. Kjo, do të mundësonte pasqyrimin e qartë të punës dhe angazhimit të autoriteteve para qytetarëve të komunës.

Grupi i të rinjve ka trajtuar me vëmendje nevojën për komunikim në mes të autoriteteve dhe qytetarëve

me qëllim të ngritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare në procese. Çështjet në vijim janë identifikuar si prioritete që duhet të adresohen menjëherë dhe pa implikime buxhetore: Mungesa e informimit të qytetarëve nga ana e autoriteteve komunale për punët dhe projektet e komunës, sidomos në fazat e hershme të inicimit të projekteve. Komunikimi me qytetarë është i limituar në dy takimet vjetore të parapara me ligj.




Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

1 Autoritetet komunale të komunikojnë me qytetarët në baza të rregullta për të informuar ata mbi punët dhe projektet e planifikuara si dhe për të dëgjuar brengat dhe prioritetet e tyre. Është e domosdoshme që autoritetet lokale të informojnë qytetarët për projektet dhe veprimet e tyre që janë në interes të qytetarëve në fillim të procesit dhe jo kur ato janë vendosur dhe nisin të implementohen.

2 Të mos kufizohet numri në dy i takime publike brenda vitit me të vetmin qëllim për të përmbushur anën formale të implementimit të ligjit. Informimi për takimet e tilla të jetë më i shtrirë dhe më i mirë – qytetarët edhe në viset rurale të jenë të informuar mirë dhe me kohë për takimet. Një vendosje e komunikimit me udhëheqës të fshatrave do të ndihmonte shumë në përcjelljen e informatave të drejta dhe me kohë tek qytetarët.

3 Me qëllim të informimit sa më të mirë dhe në kohë të qytetarëve për punën dhe projektet e planifikuara, autoritetet komunale do të mund të instalonin dhe të vënin në funksion lehtë një aplikacion në internet që do të përditësohej rregullisht dhe do të përfshinte informacione për projektet komunale me interes për qytetarët nga faza e planifikimit të tyre. Një aplikacion i tillë do të ishte në veçanti në shërbim të qytetarëve të rinj në komunë.





3

SEKTORI I ARSIMIT



Problemet e identifikuara:

Mungesa e hapësirave për lexim është një problem evident me të cilin ballafaqohen nxënësit por edhe studentët dhe që kërkohet të trajtohet me prioritet nga ana e autoriteteve lokale. Problemet që jo rrallë përcillen me sjellje devijante nga ana e nxënësve (në raste të caktuara), konsiderohen në masë të madhe si pasojë e pamundësisë për konsultime me psikologun. Rëndom, problemet e tilla vijnë si rezultat i moshës së caktuar të nxënësve. Grupi i të rinjve ka identifikuar këtë dukuri si problem që duhet të adresohet nga ana e autoriteteve. Qasja jo

uniforme ndaj shkollave të mesme është priorizuar si problem tjetër që kërkon të adresohet në të ardhmen. Udhëtimi, shpeshherë i gjatë i shumë nxënësve por dhe studentëve nga zonat jashtë qytetit për në shkolla është problemi i radhës që të rinjtë kanë identifikuar si çështje që duhet të trajtohet me prioritet. Mungesa e ndriçimit të hapësirave afër shkollave jo rrallë shkakton probleme të natyrave të ndryshme dhe kësaj duhet të adresohet nga ana e autoriteteve lokale.



Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

1 Autoritetet komunale të adresojnë çështjen e krijimit të hapësirave për lexim për nxënës të shkollave të mesme dhe studentëve. Nevoja për hapësirë leximi është shtuar në masë të madhe pas themelimit të universitetit publik. Kërkohet që autoritetet të gjejnë mundësi për krijimin e hapësirës së nevojshme për lexim.

2 Autoritetet lokale të sigurojnë mundësinë për nxënës, nga klasa e 8-të fillore dhe klasëve të shkollimit të mesëm, për komunikim me psikologun. Arsyetimi qëndron në faktin që paraqitja e sjelljeve devijante në shumë raste vie si rezultat i moshës së caktuar dhe konsultat me psikologun mund të ndihmonin shumë në tejkalimin e tyre. Varësisht nga mundësitë financiare, autoritetet lokale mund të pilotonin së paku një projekt ku do të siguronin praninë e psikologut në disa shkolla më të mëdha për kohë të caktuar (një ose më shumë javë) në baza rotative. Në rast të efekteve pozitive të vazhdohet dhe zgjerohet në më shumë shkolla ose në të gjitha shkollat.

3 Ndonëse mund të ketë kosto të lartë financiare dhe mund të jetë vështirë i realizueshëm nga ana e komunës, ndërtimi i një kampusi për shkollat e mesme propozohet si çështje tjetër prioritare nga ana e grupit të rinjve. Konsiderohet që një projekt i tillë do të ndikonte në rritjen e cilësisë duke mbajtur përqendrimin e nxënësve në hapësirat brenda kampusit si dhe do të ngrite imazhin e nxënësve dhe mësimit dhe nxënësve. Andaj, autoritetet komunale do të duhej të mendonin për zgjidhje të mundshme.

4 Autoritetet duhet të nxjerrin vendim për një pilot projekt, së paku në fillim, për sigurimin e transportit për nxënës dhe studentë nga fshatrat e mëdha me numër më të madh nxënësish dhe studentësh. Transporti vazhdon të mbetet problem i madh për shumë nxënës dhe studentë sidomos atyre që udhëtojnë nga fshatrat. Autoritetet duhet të aplikojnë qasje uniforme ndaj të gjitha shkollave dhe rrjedhimisht të gjejnë mundësi për pajisjen me kabine gjegjëse të shkollave edhe në fshatra ashtu që të ngritët niveli i cilësisë dhe të jetë konkurrues me shkollat në qytet.

5 Autoritetet komunale duhet ta trajtojnë me prioritet ndriçimin e rrugëve pranë objekteve shkollore me qëllim të evitimit të shumë problemeve që ballafaqojnë të rinjtë. Jo rrallë, mungesa e ndriçimit shkakton frikë për nxënës në turnin e pasdites, por edhe ka pasur raste kur problemet kanë qenë edhe të natyrave tjera.





4

SEKTORI I TURIZMIT



Problemet e identifikuara:

Duke e konsideruar me prioritet potencialin dhe pasuritë që ofron qyteti për turizëm, grupi i të rinjve ka identifikuar disa nga çështjet që aktualisht janë problematike dhe kërkojnë adresim të menjëhershëm nga ana e autoriteteve lokale. Ndonëse, të njëjtat paraqesin probleme evidente, mund të adresohen lehtësisht dhe jo të gjitha kanë implikime buxhetore – thjesht me vullnet të mirë mund të ofrohen zgjidhje. Mungesa e guidave të mjaftueshme turistike në qytet

sidomos gjatë sezonës verore kur fluksi i vizitorëve shumëfishohet paraqet problem serioz në promovimin dhe kultivimin e turizmit. Gjendja aktuale e qendrës historike e cila në vazhdimësi po keqësohet duke rrezikuar seriozisht edhe shkatërrimin, paraqet një tjetër problem që duhet trajtuar me prioritet. Një problem tjetër që është identifikuar nga ana e të rinjve është edhe mungesa e WC-ve publike në qytet.




Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

1 Autoritetet komunale duhet të gjejnë mundësi për shtimin e guidave turistike, sidomos gjatë sezonës verore kur numri i vizitorëve në qytet rritet. Të ketë shpërndarje të guidave – do të mund të vendoseshin në kiosqe ose objekte tjera, në më shumë pjesë të qytetit, në mënyrë që qasja për vizitorët të jetë e lehtë. Një mundësi mund të ishte përzgjedhja e disa studentëve që njohin gjuhë të huaja dhe përfitimet do të ishin të dyanshme – studentët do të kryenin një përvojë pune dhe do të përfitonin materialisht, derisa autoritetet komunale do të ofronin një shërbim më cilësor për vizitorët në komunën tonë. Padyshim kjo do të ndihmonte në përmirësimin e imazhit të komunës dhe qytetit.

2 Autoritetet komunale duhet me prioritet të trajtojnë nevojën për restaurimin e qendrës historike dhe kësajqë të ndalet degradimi i mëtejshëm i saj. Ndonëse qendra historike bie edhe në kompetencë të nivelit qendror, është domosdoshmëri që niveli lokal ta adresoj me shumë prioritet këtë problem dhe të insistoj në zgjidhjen e qëndrueshme të qendrës që paraqet një pasuri jo vetëm për qytetin tonë por për gjithë vendin. Përpjekjet e deritanishme kanë qenë të pamjaftueshme dhe më tepër me karakter reaktiv kur probleme të caktuara rreth qendrës janë shfaqur në opinion dhe ka munguar qasja proaktive e autoriteteve për këtë çështje.

3 Në vazhden e prioriteteve të mësipërme, autoritetet lokale duhet të trajtojnë nevojën për identifikimin e gjejnë hapësirave adekuate dhe të ndërtojnë WC publike në qytet.





5

SEKTORI SOCIAL



Problemet e identifikuara:

Problemet që ballafaqojnë kategoritë e qytetarëve me aftësi të kufizuara janë trajtuar me vëmendje të veçantë nga ana e grupit të të rinjve. Krijimi i lehtësirave dhe kushteve për këto kategori që ndihmojnë integrimin e tyre në shoqëri duhet të jenë prioritet permanent i secilës qeveri lokale dhe i të gjithë qytetarëve. Në vijim janë çështjet e identifikuara si prioritare që kërkojnë të adresohen nga ana e autoriteteve lokale: Mungesa e infrastrukturës adekuate për qasje në

objektet publike për personat me aftësi të kufizuara. Mungesa e elementeve gjegjëse në infrastrukturën rrugore që lehtësojnë qasjen dhe lëvizjen e këtyre kategorive të qytetarëve. Qytetarët nga këto kategori përballen edhe me mungesë të një qendre që do të ofronte hapësirë dhe kushte për takime dhe aktivitete të tyre.




Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:


1 Autoritetet komunale të trajtojnë me prioritet problemet dhe sfidat që ballafaqojnë këto kategori të qytetarëve duke ndërtuar infrastrukturë adekuate që mundëson qasjen e tyre në objektet publike. Të identifikohen të gjitha objektet publike ashtu si edhe të gjitha shkollat ku mungojnë pjerrinat për qarkullim të karrigeve lëvizëse dhe të njëjtat të vendosen me prioritet.

2 Të vendoset shiriti i gjelbër nëpër pjesët kryesore të rrugëve në qytet. Mund të fillohet me sheshet kryesore dhe hapësirat e frekuentuara për të vazhduar në pjesët tjera të qytetit.

3 Autoritetet lokale duhet të trajtojnë me prioritet nevojën për krijimin e një hapësire – qendre e cila do ofronte mundësi për takimet e tyre dhe aktivitetet tjera të tyre.

4 Po ashtu, duhet të gjejnë mundësi për mbështetjen me mjete financiare e Shoqatës së Handikos-it me qëllim që t'u ofrohen shërbime dhe mundësi qytetarëve me aftësi të kufizuara.





Grupi i të rinjve që kanë kontribuar në hartimin e kësaj propozim-platforme:

AGON HUKALLO

ELITA OMAJ

ILIRJAN MEKANI

ALBAN XHEMAJ

EMIR BALJE

KRESHNIK KOKOLLARI

ALBRIM BADALLAJ

EMIRA GAVAZAJ

NAZIFE KOKOLLARI

ARBËR KRASNIQI

ENKELA KARAVIDAJ

SABINA TAHIRI

BESAR GËRGI


FESTIM AVDYLI

URATA KRASNIQI

EDI BUSHATI

ILIRIJANA TAHIRI





**Duke pasur parasysh kufizimet
buxhetore si dhe problemet që
ballafaqojnë komunat në procesin
e hartimit të buxheteve komunale,
diskutimi dhe puna e grupeve të të
rinjve është orientuar në identifikimin
e çështjeve që janë të prekshme,
të zbatueshme dhe që në pjesën
më të madhe nuk kanë implikime
të mëdha buxhetore.**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Projekti është mbështetur nga:



British Embassy
Pristina